

## Titulli i lëndës: Gjuha angleze

Informatat themelore të lëndës:	
<b>Njësia akademike:</b>	Fakulteti i Ndërtimtarisë
<b>Titulli i lëndës:</b>	Gjuha angleze
<b>Niveli:</b>	Bachelor
<b>Statusi i lëndës:</b>	Obligative
<b>Viti i studimeve:</b>	Viti 1, Semestri 1
<b>Numri i orëve në javë:</b>	2+0
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	3
<b>Koha / Vendi:</b>	Fakulteti i Ndërtimtarisë (Salla 415)
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	Msc./Kandidate doktrate Ardita Ibishi
<b>Të dhënat kontaktuese:</b>	Mob: +383 49866320 Email: <a href="mailto:ardita.ibishi@uni-pr.edu">ardita.ibishi@uni-pr.edu</a> <a href="mailto:ardita.ibishi@umib.net">ardita.ibishi@umib.net</a>
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	Lënda e gjuhës angleze ka për qëllim zhvillimin e përgjithshëm të shkathtësive akademike të studentëve. Për më tepër, tenton të arrijë përmirësimin e kohëve dhe strukturave gramatikore për një përdorim më të saktë në jetën e përditshme. Qëllimi kryesor i lëndës është të ju mundësojë studentëve përdorimin e gjuhës teknike dhe profesionale sipas fushave studimore në Fakultetin e Ndërtimtarisë. Gjatë semestrit, libri kryesor do të shoqërohet nga materiale shtesë siç janë fletë pune/ushtime, tekste, ushtime dëgjimi, përkthime dhe prezentime të studentëve.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Përmes kësaj lënde studentët mund të: -zhvillojnë dhe përmirësojnë shkathtësitë e të folurit, dëgjimit, leximit dhe shkrimit -rrisin njohuritë e tyre rreth gjuhës teknike angleze sipas fushave të tyre të studimit dhe pasurojnë fjalorin e tyre të përgjithshëm dhe specifik -përmirësojnë gramatikën dhe përdorimin e saj -përmirësojnë komunikimin dhe të folurit në publik
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	Pas përfundimit të kësaj lënde studentët do të arrijnë: -pervetësim të gjuhës së përgjithshme dhe teknike angleze -zhvillim të shkathtësive akademike dhe aplikimin e tyre në jetën e përditshme -të kuptuar më të mirë të terminologjisë teknike -komunikim më të mirë me profesionistë të fushave të ndryshme dhe përgaditje më të lartë në prezentimin e punës së tyre.

**Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies të studentit)**

<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike	/	/	/
Përgaditje për test intermediar	2	2	4
Konsultime me mësimdhënësin	1	15	15
Puna në terren	/	/	/
Testi, punimi seminarik	2	2	4
Detyrë shtëpie	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja për provimin final	1	15	15
Koha e vlerësimit (teste,kuiz,provim final)	4	2	4
Projektet, prezentimet etj.	4	2	4
Shto ndonjë aktivitet tjetër që nuk është në tabelë...	/	/	/
<b>Totali</b>			<b>136</b>
<b>Metodat e mësimdhënies:</b>	Ligjërata dhe ushtrime 2 orë në javë Prezentime 2-3 termine në semestër Projekte dhe diskutime te ndryshme		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Pjesëmarrja dhe aktiviteti në klasë: 10%Prezentimi: 10% Test 1: 40% Test 2: 40% Totali: 100 % Provimi final : 100% Studenti/ja fiton një notë dhe nuk është i/e obliguar të hyjë në provimin final, përveq nëse nuk është i/e kënaqur me notën. Nëse studenti e refuzon notën e testeve dhe hyn në provimin final, atëherë nota e mëparshme humbet dhe nota përfundimtare mbetet ajo e provimit.		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura primare:</b>	<u>Career Paths: Engineering (2011).</u> Charles Lloyd & James A. Frazier. Express Publishing.		
<b>Literatura shtesë:</b>	Fletë pune, ushtrime, dhe tekste të zhvillimit të lexuarit dhe kuptuarit do të përdoren për të krijuar diskutime të mëtejshme dhe avancim të gjuhës.		

**Plani i dizajnuar i mësimit:**

<b>Java</b>	<b>Titulli i ligjëratës</b>
<b>JAVA 1</b>	Hyrje në lëndë, literatura dhe metodat e vlerësimit. Diskutim lidhur me fushat studimore të studentëve.
<b>JAVA 2</b>	Njësia 1- Çfarë është inxhinieria? Material shtesë: Historia e inxhinierisë
<b>JAVA 3</b>	Njësia 2 – Format
<b>JAVA 4</b>	Njësia 4 – Materialet Material shtesë: Materialet ndërtimore
<b>JAVA 5</b>	Prezentime
<b>JAVA 6</b>	Njësia 4– Veglat Njësia 5 - Energjitë.
<b>JAVA 7</b>	Njësia 7 – Puna me numra Njësia 8 – Llojet e matjeve
<b>JAVA 8</b>	Njësia 9 - Masat paraprake të sigurisë & Siguria në punë. Fletë punë e kohëve në gjuhën angleze
<b>JAVA 9</b>	Prezentime Material shtesë: Gratë në inxhinieri & Diskutim
<b>JAVA 10</b>	Karrierat e “gjelbërta” – Topografët Matjet dhe mjetet e matjeve
<b>JAVA 11</b>	Hidraulika dhe punimet hidraulike
<b>JAVA 12</b>	Inxhinieria sanitare dhe e ambientit
<b>JAVA 13</b>	Material shtesë: Sinonimet dhe antonimet
<b>JAVA 14</b>	Shkrimi i një CV-je dhe letre motivuese
<b>JAVA 15</b>	Diskutim dhe rezultatet përfundimtare

**Politikat akademike dhe kodi i mirësjelljes:**

Studentët duhet të jenë të përpiktë dhe të respektojnë profesorin e lëndës dhe kolegët e tyre. Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë, prandaj studentët duhet të vijojnë ligjëratat dhe ushtrimet e të jenë aktivë në mësimet.

Libri është i obligueshëm për studentë duke marrë parasysh natyrën e lëndës. Ndalohet përdorimi i telefonëve gjatë ligjëratave, testeve apo provimeve.